

VENDIM
Nr. 1053, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR PAJISJET E MBROJTJES
PERSONALE (PMP)”¹ DHE PËRCAKTIMIN E LISTËS SË STANDARDEVE TË
HARMONIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 17, 5, pika 2, 6 e 42, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet e mbrojtjes personale (PMP)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues për prezumimin e konformitetit të pajisjeve PMP referuar në pikën 1, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Standardet e harmonizuara shqiptare, numrat dhe titujt e të cilave janë përfshirë në listën e përmendur në pikën 2, të këtij vendimi, shërbejnë si dokumente reference për prezumimin e konformitetit të pajisjeve referuar në pikën 1 me kërkesat thelbësore të sigurisë, të përcaktuara në rregullin teknik që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Direktiva 89/686EEC, 21 dhjetor 1989 “Për pajisjet të mbrojtjes personale (PMP)”, numri Celex 31989L0686, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.399, datë 30.12.1989, faqe 18-38.